

# L I G J

Nr. 8951, date 10.10.2002

## PER NUMRIN E IDENTITETIT TE SHTETASVE

Ne mbështetje te neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

## K U V E N D I I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

### V E N D O S I:

#### Neni 1

Qëllimi i ligjit është përcaktimi i kuptimit, mënyrës se formimit dhe sferës se përdorimit te numrit te identitetit, si një nga përbërësit e veçante te gjendjes civile, i cili përcakton dhe shërben për identifikimin e shtetasve shqiptare, personave pa shtetësi dhe shtetasve te huaj me qëndrim te përhershëm brenda territorit te Republikës se Shqipërisë.

#### Neni 2

1. Numri i identitetit është unik dhe vendoset nga shërbimi i gjendjes civile. Ai përbëhet nga dhjete elemente me informacion te koduar dhe ka strukturën e mëposhtme:

Elementi 1-2	viti i lindjes
Elementi 3-4	muaji i lindjes dhe seksi
Elementi 5-6	data e lindjes
Elementi 7 -9	numri serial brenda se njëjtës date
Elementi 10	element kontrolli.

2. Numri i identitetit lëshohet nga shërbimi i gjendjes civile.

#### Neni 3

Numri i identitetit shërben:

1. Për Regjistrin Kombëtar te Gjendjes Civile.
2. Për dokumentin e identitetit.
3. Si numër i sigurimit shoqëror për te identifikuar, regjistruar dhe për te kërkuar përfitime nga sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe për programet e tjera te mbrojtjes shoqërore.
4. Për Regjistrin Kombëtar te Zgjedhjeve.
5. Për sistemin tatimor .
6. Për dëshminë e aftësisë se drejtimit te automjeteve.
7. Për nevojat e organeve dhe te institucioneve te tjera shtetërore, si organeve te drejtësisë, te rendit, te prokurorisë, te mbrojtjes, te arsimit dhe te Zyrës se Regjistrimit te Pasurisë.

#### Neni 4

Mënyra e kodimit te numrit te identitetit, masat dhe detyrat e organeve shtetërore për pajisjen e shtetasve me numër identiteti, përcaktohen me vendim te Këshillit te Ministrave.

## Neni 5

Paragrafët e pare dhe te dyte te nenit 1, nenet 2, 3, 6, 7, si dhe paragrafi i trete i nenit 13 te ligjit nr. 7845, date 13.7.1994 "Për numrin e sigurimit shoqëror", shfuqizohen.

## Neni 6

Ky ligj hyn ne fuqi 12 muaj pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr, 3541, date 7.11.2002 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë,  
Alfred Moisiu